



## Titulli i projektit

Ndërtim i rrugës për këmbësorë e biçikleta përgjatë bregut të Liqenit të Shkodrës

## Tipi i projektit

Shërbimet publike/Sektori strategjik i turizmit/  
Sektori i shërbimeve

## Vendndodhja e projektit

Vija bregore e Liqenit të Shkodrës në ZF Malësi e Madhe  
NJQV Qendër, Kastrat, Koplik, Gruemirë

## Buxheti i paravlerësuar

N/A

## Përshkrimi dhe analiza e problemit/eve

Ndër gjetjet e analizës ekonomike të programit të zonës funksionale mbi gjendjen e tanishme të sektorit të turizmit në pjesën fushore të zonës funksionale Malësi e Madhe, është mungesa e theksuar e infrastrukturës rrugore në fshatrat e bregut të Liqenit të Shkodrës, si dhe e aktiviteteve zbavitëse përgjatë tij. Kështu, projekt-idea për ndërtimin e një rruge për këmbësorë e biçikleta përgjatë bregut të Liqenit i përgjigjet nevojës për të nxitur turizmin liqenor, por jo vetëm. Në gërshetim me tërheqjen e vizitorëve, ndërtimi i kësaj rruge mund t'i japë nxitje tregtisë së produkteve vendase, restoranteve, kampingjeve e formave të tjera të zhvillimit të sektorit të shërbimeve, ndërsa është në funksion dhe të përmirësimit të shërbimeve publike të njësisë së ardhshme vendore.

## Qëllimi/et specifik të projektit

Objekti i projektit është nxitja e zhvillimit të turizmit liqenor në pjesën fushore të zonës funksionale, përmes shtimit të mundësive të veprimtarive dhe argëtimit të banorëve e vizitorëve. Projekti mund të sjellë përfitim në radhë të parë për banorët e njësisë vendore me dalje në liqen, që janë Komuna Qendër, Kastrat, Gruemirë dhe Koplik, përmes zhvillimit ekonomik, por edhe përmirësimit të infrastrukturës rrugore përreth tyre.

## Rezultatet e pritshme dhe treguesit

Rezultatet e pritshme të projektit janë:

1. një rrugë këmbësorësh dhe biçikletash e ndriçuar përgjatë bregut të Liqenit të Shkodrës në Malësi të Madhe (rreth 30 km);
2. rritje e aksesit drejt liqenit, duke marrë parasysh se deri më tani, një lloj i tillë rruge mungon në gjatësinë më të madhe të vijës bregore;
3. rritje e numrit të vizitorëve dhe zhvillim të sektorit të shërbimeve.

Numri i banorëve të katër njësisë vendore që kanë dalje në liqen, pra drejtpërdrejt përfitues i ndërtimit të rrugës, është rreth 42000 (afërsisht 77 % të popullsisë së gjithë zonës funksionale).



## Aktivitetet e projektit

Projekti mund të zhvillohet sipas fazave të mëposhtme të punimeve:

1. Rikonstruksion i shtresave të rrugës, vendosja e shtresave të asfaltit;
2. Ndërtim i trotuareve;
3. Ndërtim i një korsie për biçikleta;
4. Punime elektrike për ndriçimin e rrugës.

Për një gjatësi rruge rreth 30 km parashikohet një kohë punimesh ndërtimi rreth 3 vjet.

## Maturimi i projektit

Projekti është një ide e nisur në bazë të nevojave të zhvillimit ekonomik dhe infrastrukturor të gjetura nga analiza e Programit të Zonës Funksionale.

Aktivitetet paraprak kyç, që do të nevojitet, është një studim urbanistik e teknik i të gjithë vijës bregore të liqenit, përgjatë së cilës është më e përshtatshme të kalojë rruga. Ky aktivitet do t'i japë qëndrueshmëri projektit.

## Burimet e financimit dhe partnerët në zbatim

Donatorë të mundshëm për këtë projekt janë identifikuar: buxheti i qeverisë qendrore, buxheti i qeverisë vendore, Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe BE.

## Kostot e projektit

Në bazë të investimeve në infrastrukturën rrugore të vendit, të financuara nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit gjatë viteve 2005-2013 (referuar veçanërisht ndërtimit të një rruge të ngjashme në segmentin Shkodër-Shirokë), mund të përafrojmë një kosto të ndërtimit të një rruge këmbësorësh dhe biçikletash prej 33,800,000 lekë/km, ose 245,000 euro/km.